

Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 dhe n; lidhje me nenin 114 paragrafi 3 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 4 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, KSHPK duke vepruar me vetiniciativë, në seancën e 59-të, të mbajtur më datë 14.01.2022 morri

Vendim

Procedura e iniciuar sipas detyrës zyrtare nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ndaj zyrtarit /// – ushtrues detyre/// ndërpritet, sepse ka vepruar pas Njoftimit nr. 09-3254/4 datë 16.09.2021, i cili konstatoi shkelje të kufizimeve të parashikuara në nenin 45 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i njëjti veproi sipas detyrimeve nga njoftimi në fjalë.

Gjithashtu, pas një urdhërpagese kundërvajtëse me nr. 09-3254/3 nga data 16.09.2021, në afatin e paraparë me ligj ka paguar gjobën e parashikuar në nenin 105 paragrafi 1 alineja 2 të të njëjtit ligj.

Lënda me numër 09-3254/1 të dat;s 02.09.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Arsyetim

Lënda me numër 09-3254 / 1 nga 02.09.2021 është formuar me vetiniciativë në bazë të kontrollit të rregullt të Formularit – Deklaratës së interesit të dorëzuar nga /// – ushtrues detyre ///, sepse pas përzgjedhjes në Funkcionin e mësipërm, menaxhimi me ///i është besuar një anëtar i familjes së tij (bashkëshortes), gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

/// është emëruar ushtrues detyre /// me aktin nr. 20-10378 / 1 datë 03.11.2020. Pas kontrollit në Sistemin e Shpërndarjes së Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 13.07.2021, është konstatuar se personi i përmendur përmes parashtruesit /// ka dorëzuar kërkesë për ndërrim të menaxherit të /// më/// në regjistrin e RMV-së, dhe për menaxhues të kësaj kompanie tregtare është emëruar personi ///, bashkëshortja e ///.

Kjo situatë e konstatuar është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, ku KSHPK-ja i ka kërkuar personit në fjalë që brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit ta largojë situatën e konstatuar, përkatësisht menaxhmentit të /// për t'ia besuar një personi tjetër, përveç anëtarëve të familjes së tij.

Nē bazē tē nenit 114 paragrafi 3 tē Ligjit pēr Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit tē Interesit, KSHPK-ja ka lēshuar dhe dorēzuar tē nјјtiti person urdhērpagesē pēr kundērvajtje pēr shkelje tē nenit 45 paragrafit 1 tē Ligjit pēr Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit tē Interesit, dēnueshēm sipas nenit 105 paragrafi 1 alineja 2 tē tē nјјtiti ligj.

Me datē 15.10.2021, ///, nē KSHPK ka dorēzuar kopjen e fletēpagesēs pēr pagesēn e gjobēs pas urdhērpagesēs pēr kundērvajtje nr. 09-3254 / 3 datē 16.09.2021. Me datē 02.11.2021, i nјјtiti person ka dorēzuar nē KSHPK Vendim pēr ndryshimin e personit tē autorizuar mē ///, gjegjēsisht si menaxher i personit juridik nē fjalē ēshtē emēruar ///.

Duke pasur parasysh tē theksuarēn e mēsipērme, Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit vendosi si nē dispozitēn e kētij vendimi.

KOMISIONI SHTETЌОРОР
ПЉР PARANDALIMIN E KORRУSIONIT
Nēnkryetar
Goran Trpenoski

Sipas pērfundimit tē KSHPK-sē,
Punoi: SM, bashkēpunētōr i lartē
Miratoi: Mr.VG, anētār i KSHPK-sē

